



V-9

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**  
**DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT**

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Website: [www.hidaa.gov.al](http://www.hidaa.gov.al), E-mail: [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al)

Nr. Indek në ILDKI dhe Viti	2016
-----------------------------------	------

**DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE**  
**PERIODIK / VJETOR**

Plotësohet nga zyrtari që mbart detyrimin për deklaram të interesave private të tij, të bashkëshortit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr.9367, dt.7.4.2005, Ligjin nr.9475, dt.9.2.2006, Ligjin nr.9529, dt.11.5.2006 Ligjin nr. 85/2012, datë 18.09.2012 dhe Ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014.

**A U T O R I Z I M**  
**PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE**

<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>
Anduel	Fatmir	Xhindi
<b>Funksioni</b>		
Deputet		
<b>Institucioni dhe adresa</b>		
Kuvendi i Shqiperise		
<b>Data e emërimit në funksionin që kryen</b>		<b>Data e dorëzimit të deklaratës</b>
17.11.2011		30.03.2017

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ” i ndryshuar,

**A u t o r i z o j:**

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i zyrtarit

**NDRYSHIMET E PASURIVE  
DHE  
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie\* të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

\* **Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash**, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit

Anduel Xhindi



*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.*

**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET  
NË VEPRIMTARI  
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa , nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
Te ardhura nga paga ime prane Kuvendit te Shqiperise	2 894 190(dy milion e teteqind e nentdhjete e kater mije e njeqind e nentembdhjete) leke.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit

**Anduel Xhindi**

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.*

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura nga zyrtari gjatë vitit të deklarimit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve keni detyrime financiare të pasqyrohen në faqen nr.7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.


**Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.**

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)
1. Kredi per blerje makine, prane [redacted] Bank, sasia 2 162 000(dy milion e njeqind e gjashtedhjet e dy mije)leke.	487 297(katerqind e tete e shtate mije e dyqind e nentedhjet e shtate) leke.	1 926 803 (nje milion e nenteqind e njezet e gjashte mije e teteqind e tre) leke.
2. Overdraft pranë Bankes [redacted]	390 000( treqind e nentedhjet mije) leke ( pagesa eshte 20 000 (njezete mije leke, ne muaj), marre ne muajin mars 2016.	

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në fotokopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit

**Anduel Xhindi**



## Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në dy ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligj nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

### Deklarimi i interesave private nga zyrtari

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private priodik/vjetor” duhet të plotësohet nga zyrtari në funksion, por **edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më pak se një vit nga funksioni i mëparshëm.**
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter). Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkesave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.
- Subjekti/zyrtar nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, deri më 31 Mars të çdo viti.

Bashkëlidhur Deklarimit të interesave private zyrtari duhet të dorëzoj: kopje të Letër Njoftimit ( Kartës së Identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.

Për fëmijët e tjerë zyrtari duhet të dorëzoj fotokopje të Pasaportës ose të Çertifikatës personale.

Mosplotësimi i këtij detyrimi passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI

dhe për pasojë ndaj zyrtarit do të aplikohen sanksione për refuzim të deklarimit të interesave private.

### Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, **për pasuritë që disponojnë veçmas.**
- Subjekti/Personi i lidhur me zyrtarin, (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore) i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, subjekti deklarues personi i lidhur është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës “AUTORIZIMI”, ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

### Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar
- Për mosdeklarim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, deklaruesi dënohet me gjobë nga 50.000 lekë deri në 100.000 lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

**Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklarimit duhet të nënshkruhen nga deklaruesi në të kundërt, deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e pa dorëzuar në Inspektoratin e Lartë.**

- Për informacione të mëtejshme apo asistencë në plotësimin e deklaratës, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me “Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse” në numrat e telefonit **042 259 461**, Falas 08009999, [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al) .
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.